



PREVENT
INSTITUTI PËR SIGURI DHE REZILIENCË

Autor

SKENDER PERTESHI

Rreziqe të padukshme: Transformimi i shkaktarëve të terrorizmit në Kosovë dhe rajon

Korrik, 2024



PREVENT

Instituti për Siguri dhe Reziliencë

Tabela e përmbajtjes

HYRJE	2
RREZIQET E TERRORIZMIT NË BALLKAN DHE EVROPË: NDIKIMET NGA SHITETET JO MIKE	3
KËRCËNIMET NGA TERRORIZMI PËR KOSOVËN NË NJË BOTË TË PASIGURTË	6
KATEGORIZIMI DHE SHPALLJA E ORGANIZATAVE TERRORISTE NË KOSOVË	7
AKTET E DHUNSSHME TERRORISTE TË KRYERA NË KOSOVË NË VITET 2020-2023	9
KRONOLOGJI E SULMEVE SERIOZE TERRORISTE TË REALIZUARA NË KOSOVË NË TRI VITET E FUNDIT	10
SULMI TERRORIST NË FSHATIN BANJSKË	11
SEKUESTRIMI I SASISË SË MADHE TË ARMËVE NË VERIUN E KOSOVËS	12
KATEGORIZIMI I ORGANIZATAVE TERRORISTE NË KOSOVË	13
PËRFUNDIMET	15
REKOMANDIMET	15

Mendimet, analizat dhe të dhënat e paraqitura në këtë raport janë vetëm ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet ose qëndrimet e institutit ose partnerëve të tij. Ky raport është menduar vetëm për qëllime informative dhe nuk duhet të interpretohet se përfaqëson motivet, politikat ose objektivat kërkimore të ndonjë prej organizatave ose individëve brenda institutit.

Terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm mbeten ndër kërcënimet e mëdha të sigurisë në botë. Viteve të fundit, bota është përballur me sulme dhe kërcënime të shkaktuara nga forma të ndryshme të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Në nëntor të vitit 2020 ndodhi një sulm terrorist në kryeqytetin e Austrisë, Vjenë, sulm nga i cili mbeten të vrarë 4 civilë dhe mbi 14 të tjerë mbeten të plagosur. Sulmi u krye nga individë të lidhur me organizatën ISIS. Gjithashtu, më 22 mars 2024, në Moskë, kryeqytetin e Rusisë, u krye një sulm terrorist i planifikuar, organizuar dhe ekzekutuar nga celulat e ISIS-it (i njohur si ISIS-Khorasan), ku mbeten të vrarë mbi 144 persona dhe shumë të tjerë të plagosur. Poashtu në vitin 2024, autoritetet gjermane të sigurisë kanë parandaluar një sulm të madh terrorist që ishte planifikuar të ekzekutohej në qytetin Potsdam të Gjermanisë, gjatë kampionatit evropian të futbollit i cili mbajt gjatë muajve qershor-korrik 2024. Këto sulme terroriste të kryera, dhe shumë të tjera që janë parandaluar, janë tregues se përkundër ndërtimit të mekanizmave të sigurisë për luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, grupet terroriste janë ringjallur, kanë forcuar kapacitetet e tyre dhe kanë arritur të planifikojnë dhe ekzekutojnë sulme të shkallës së lartë ndaj shteteve dhe qytetarëve, madje edhe ndaj vendeve me sisteme të avancuara të sigurisë dhe mbrojtjes. Kërcënimet nga terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm janë në rritje, duke u frymëzuar nga ideologji dhe subjekte të ndryshme qoftë ato religjioze, politike apo të së djathtës ekstreme. Pushtimi rus i Ukrainës, lufta ndërmjet Izraelit dhe Hamasit, si dhe mospajtimet ndërmjet dy superfuqive botërore, Kinës dhe SHBA-së, kanë krijuar një botë të pasigurt dhe të paqëndrueshme, duke ndryshuar tërësisht burimet e rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë në botë. Në këtë kontekst, kanë ndryshuar edhe burimet e kërcënimeve dhe rreziqeve nga terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë dhe Ballkan. Përderisa kërcënimet terroriste të motivuara nga radikalët islamikë, si ato nga ISIS, viteve të fundit janë vënë nën kontroll nga institucionet e sigurisë dhe ato të zbatimit të ligjit, tanimë në Kosovë, në masë të madhe janë përhapur elemente terroriste dhe ekstremiste të motivuara nga elemente etno-nacionaliste, dhe të së djathtës ekstreme të mbështetura nga autoritete shtetërore dhe joshtetërore si Rusia, Serbia apo Irani. 4 Ndryshimet gjeopolitike që po ndodhin në botë aktualisht kanë ndryshuar prioritetet dhe. angazhimet e shteteve perëndimore (sidomos vendeve të BE-së) ndaj vendeve si Kosova dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi, duke përfshirë këtu edhe mbështetjen e tyre për adresimin e kërcënimeve dhe rreziqeve që vijnë nga forma të ndryshme të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Për këtë fakt, në planet e

1 Per me shume ju lutem shihni linkun ne artikullin e lajmeve te Radios Evropa e Lire:

<https://www.evropaelire.org/a/30926603.html>

2 Për më shumë shih "Rusia ka parë dy sulme të mëdha terroriste në vetëm tre muaj. Ja çfarë dimë"

<https://edition.cnn.com/2024/06/24/europe/russia-dagestan-attacks-explainer-intl-hnk/index.html>

3 Për më shumë shih, artikullin në [https://www.gbnews.com/news/world/euro-2024-isis-terror-plot-](https://www.gbnews.com/news/world/euro-2024-isis-terror-plot-germany-police)

[germany-police](https://www.gbnews.com/news/world/euro-2024-isis-terror-plot-germany-police)

4 Po aty

shumë shteteve dhe institucioneve ndërkombëtare, terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk e ka më vëmendjen njëjtë të cilën e kishte para pandemisë COVID- 19.⁵

Partnerët strategjikë dhe aleatët ndërkombëtarë të Kosovës, të cilët për një kohë të gjatë kanë luajtur rol të rëndësishëm në mbështetjen e Kosovës dhe rajonit për luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, tani fokusin e tyre politik, ushtarak dhe financiar gradualisht po e zhvendosin në rajone të ndryshme të krizave globale.⁶ Kjo zhvendosje graduale e fokusit të tyre ka ndikuar që rajoni i Ballkanit Perëndimor të mbetet i brishtë ndaj përhapjes së formave të ndryshme të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ky vakum i krijuar, gradualisht po shfrytëzohet nga vende, si Rusia, Serbia dhe Irani, të cilët po forcojnë ndikimin e tyre në rajon, duke synuar që të krijojnë një terren të përshtatshëm për përhapjen e një fronti të ri të konfliktit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me qëllimin kryesor për të minuar rolin dhe ndikimin e Perëndimit në këtë pjesë të Evropës.

Mbështetja që Serbia dhe Rusia po ofrojnë për grupet e dhunshme të së djathtës ekstreme dhe etno nacionaliste, të cilat janë të pranishme në veri të Kosovës, përfshinë trajnime ushtarake, furnizim me armatime, përhapje të propagandës dhe lajmeve të rreme për të nxitur urrejtje mes komuniteteve që jetojnë në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë apo Maqedoninë e Veriut,⁷ në funksion të polarizimit ose përçarjes së komuniteteve që jetojnë në këto shtete dhe për të përhapur pasiguri dhe jo stabilitet në Ballkan. Mbështetja e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm nga Serbia dhe Rusia ka krijuar kushtet dhe terrenin e përshtatshëm për rritjen e grupeve ose ekstremiste të dhunshme në veriun e Kosovës, si Mbrojtja Civile dhe Brigada e Veriut të cilat paraqesin rrezik për institucionet vendore të sigurisë dhe për popullsinë civile që jeton në këtë pjesë të vendit.⁸



5. Intervistë me njohës të marrdhënieve ndërkombetare. Prishtinë, Maj, 2024

6 Për më shumë shih artikullin e Aljazeera “The West has lost the plot in the Balkans”
<https://www.aljazeera.com/opinions/2023/6/11/the-west-has-lost-the-plot-in-the-balkans>

7 Raporte zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Prishtinë 2024. Incizime të publikuara nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Nëntor-Dhjetor 2023

8 Intervistë me njohës të çështjeve të sigurisë. Prishtinë, Qershor 2024

Rreziqet e terrorizmit në Ballkan dhe Evropë

Ndikimet nga shtetet jo mike

Raporte të shumta vlerësojnë dhe analizojnë rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, të cilat parashikojnë veprime sabotuese nga individë dhe organizata terroriste që kanë mbështetje dhe përgatitje nga autoritete shtetërore si Rusia apo Irani. Këto veprime organizohen dhe zbatohen nga individë të financuar e kontrolluar nga Rusia, të cilët kanë planifikuar sulme sabotuese ndaj popullatës civile dhe aseteve strategjike brenda vendeve të Bashkimit Evropian dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor. Për më shumë, agjencitë e sigurisë dhe inteligjencës së vendeve demokratike si ato të SHBA-së, Gjermanisë, Francës, e Britanisë së Madhe dhe vendeve të NATO-s kanë raportuar për një rritje të rasteve të dhunës dhe sulmeve ndaj infrastrukturës kritike të vendeve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.

Hetimet tregojnë se këto sulme janë planifikuar nga agjencitë ruse të sigurisë.⁹ Lidhur me organizimin e sulmeve terroriste brenda kufijve të BE-së është deklaruar shefi i Shërbimit të Brendshëm të Gjermanisë, z. Thomas Haldenäng. Sipas tij, rreziku i sulmeve dhe akteve të sabotimit të kontrolluara nga shteti rus është në rritje, me Rusinë që nxit dhe mbështet

organizimin e sulmeve brenda territorit të BE- së.¹⁰ Individë dhe agjentë rusë kanë filluar të ndërmarrin sulme ndaj hekurudhave në vendet e BE-së. Përveç kësaj, agjentët dhe individët e lidhur me Rusinë kanë filluar të zbulojnë informacione të ndjeshme për infrastrukturën kritike të vendeve të BE-së, dhe të njëjtat t'i ndajnë me shërbimet ruse të sigurisë. Sulmet kanë shënjestruar edhe zyrtarë të lartë shtetërorë të vendeve të BE-së, siç është rasti i sulmit ndaj makinës së Ministrit të Brendshëm të Estonisë, z. Lauri Läänemets, në shkurt të vitit 2024, i koordinuar nga agjentë të inteligjencës ruse bazuar në raportimin e



Shërbimit të Sigurisë së Brendshme të Estonisë.¹¹ Për më shumë, shërbimet e inteligjencës amerikane dhe gjermane kanë raportuar të kenë zbuluar dhe parandaluar përpjekjet ruse për vrasjen e drejtorit të kompanisë gjermane për prodhimin e armëve, “Rheinmetall”, z. Armin Papperger. Ky tentim atentat terrorist ishte si vazhdimësi e një serie planesh të përgatitura nga Rusia për të vrarë drejtuesit e industrisë së mbrojtjes në të gjithë Evropën të cilët po mbështesnin përpjekjet e luftës së Ukrainës kundër pushtimit rus. Plani për të vrarë Armin Papperger ishte vlerësuar si ndër sulmet terroriste më serioze deri më tani dhe qëllimi ishte që të dekurajonte kompanitë perëndimore të prodhimit të armëve që të mbështesin me armë Ukrainën.

12

9. Për më shumë shih artikullin e Financial Times “Rusia pergaditë sulme sabotuese dhe terroriste ndaj vendeve të BE-së paralajmërojnë agjencitë e inteligjencës - <https://www.ft.com/content/c88509f9-c9bd-46f4-8a5c-9b2bdd3c3dd3>

10 Po aty.

11 Për më shumë shih artikullin e lajmeve “Sulmohet makina e ministrit të brendshëm estonez - <https://news.err.ee/1609189282/interior-minister-s-car-windows-smashed-in-apparent-act-of-vandalism>

12 Për më shumë shih: <https://edition.cnn.com/2024/07/11/politics/us-germany-foiled-russian-assassination-plot/index.html>

Disa nga rreziqet për sulme që vendet e NATO-s, BE-së dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor mund të përballen janë sulmet kibernetike, të organizuara nga Rusia apo Irani, derisa sulme hibride janë kryer në të kaluarën ndaj vendeve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Rast konkret është sulmin kibernetik i kryer ndaj Partisë Social Demokrate të kancelarit aktual gjerman, Olaf Scholz, në vitin 2023,¹⁴ si dhe sulmin masiv kibernetik ndaj Shqipërisë më 2022, ku u publikuan dokumente të klasifikuara shtetërore të shtetit shqiptar. Sulmi kibernetik ndaj Shqipërisë dyshohet se është kryer nga Republika Islamike e Iranit, për shkak se Shqipëria ka strehuar një numër të madh të zyrtarëve të opozitës iraniane për shumë vite.¹⁵ Për më tepër, në maj të vitit 2024, raportohet se hakerët rusë sulmuan faqet kryesore

elektronike të institucioneve shtetërore të Kosovës, përfshirë faqen elektronike të Zyrës së Presidencës dhe Qeverisë së Kosovës. Ky sulmi ndikoi që këto platforma elektronike të institucioneve shtetërore të bëhen pothuajse jofunksionale për një kohë dhe ndodhi pas njoftimit të Qeverisë së Kosovës për të



mbështetur Ukrainën me armë, municion luftarake dhe trajnime ushtarake për nevojat e ushtrisë ukrainase kundër pushtimit rus.¹⁶

Alarme për rreziqet e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Ballkan Perëndimor, me qëllim përhapjen e konflikteve në këtë rajon, janë dhënë edhe në raportin e vlerësimit të sigurisë nga Departamenti Amerikan i Shtetit të Shteteve, në të cilin theksohet se “Ballkani Perëndimor mund të përballlet me një rritje të rrezikut të dhunës ndëretnike gjatë vitit 2024”¹⁷

Kërcënimet nga terrorizmi për Kosovën në një botë të pasigurt

Ndryshimet gjeopolitike globale, veçanërisht në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë edhe në Kosovë. Kësaj padyshim i ka kontribuar zbehja ose zhvendosja e vëmendjes ndërkombëtare për Kosovën dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor, e shoqëruar me mungesën e një strategjie të BE-së për zgjidhjen e problemeve politike ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, si ato mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo qasje e BE-së po shfrytëzohet nga organizata ekstremiste dhe terroriste si “Mbrojtja Civile” dhe “Brigada e Veriut”, të financuar nga Serbia dhe Rusia, duke rritur ndikimin e tyre në veriun e Kosovës. Këto grupe dhe organizata ekstremiste nuk kanë hezitur të përdorin dhunën si një nga mjetet e tyre kryesore për të arritur qëllimin e tyre politik. Organizatat e tilla ekstremiste, si dhe individët të lidhura me to, aktualisht janë burim kryesor i destabilitetit për qytetarët dhe institucionet e shtetit në Kosovë, me theks të veçantë në çështjet e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

13 Për më shumë shih artikullin e gazetës franceze France24.com: “Sabotazhi i dyshuar rus: Kthimi i madh i agjentëve të Kremlinit në Evropë” <https://www.france24.com/en/europe/20240510-suspected-russian-sabotage-campaigns-great-return-russian-agents-europe>

14 Për më shumë shih artikullin e Financial Times “Rusia pergaditë sulme sabotuese dhe terroriste ndaj vendeve të BE-së - paralajmërojnë agjencitë e inteligjencës” - <https://www.ft.com/content/c88509f9-c9bd-46f4-8a5c-9b2bdd3c3dd3>

15 Për më shumë shih artikullin e Radios “Evropa e Lirë”. “Çfarë dihet për grupin që qëndron pas sulmeve kibernetike në Shqipëri?” <https://www.evropaelire.org/a/sulmi-kibernetik-shqiperi-/32031879.html>


16 Për më shumë shih artikullin e DW “Gërvalla: Rusia “po kryen sulm hibrid” kundër Kosovës” <https://www.dw.com/sq/g%C3%ABrvala-rusia-po-kryen-sulm-hibrid-kund%C3%ABr-kosov%C3%ABs/a-69022707>

17 Për më shumë shih artikullin në Politico. “US report sees rising risk of ethnic violence in Western Balkans” <https://www.politico.eu/article/us-intelligence-odni-report-expects-increased-risk-of-ethnic-violence-western-balkans/>

Sfida për parandalimin dhe luftimin grupeve terroriste si “Mbrojtja Civile” dhe “Brigada e Veriut” është e madhe për shkak të mishërimit të tyre të madh me nacionalistët ekstremistë dhe individë nga ekstremi i djathtë të cilët janë aktiv në veriun e Kosovës. Për më shumë, organizatat si “Mbrojtja Civile”, dhe “Brigada e Veriut” gëzojnë një mbështetje të madhe financiare nga strukturat e krimit të organizuar dhe kontrabandës që operojnë në veriun e Kosovës dhe në Serbi. Përveç mbështetjes nga krimi organizuar, ato financohen dhe mbështeten direkt nga strukturat shtetërore të sigurisë të shtetit serb gjë që i bën këto dy organizata shumë të fuqishme dhe të rrezikshme për Kosovën.¹⁹

Në krahasim me vitet 2015-2019, kur kërcënimet më të mëdha nga terrorizmi për Kosovën vinin kryesisht nga ekstremizmi islamist përmes organizatave terroriste, si ISIS, tanimë ky trend ka ndryshuar. Pas vitit 2019, dominojnë grupet terroriste me motive etno-nacionaliste dhe të ekstremit të djathtë, si “Brigada e Veriut” e “Mbrojtja Civile”, të cilat janë bërë ndër burimet kryesore të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në vend.²⁰

Përveç rreziqeve që burojnë nga grupet terroriste të cilat operojnë në veri të Kosovës, vendi përballet edhe me elemente të ekstremizmit islamist, në masë më të ulët krahasuar me vitet e kaluara. Në Kosovë vazhdojnë të mbeten të pranishme disa nisma paralele fetare (paraxhemateve). Këto nisma paralele fetare islame operojnë jashtë juridiksionit të Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), që është i vetmi institucion zyrtar për rregullimin e organizimit të jetës fetare islame në vend. Edhe pse puna dhe aktivitetet e këtyre nismave paralele fetare (paraxhemateve) monitorohet dhe vlerësohet nga institucionet e sigurisë, siç është Policia e Kosovës, mbetet shqetësuese mungesa e transparencës në ligjërimin e tyre, pasi që ato ndiqen nga një numër i caktuar i praktikuesve fetarë.²¹ Në Kosovë ekzistojnë gjithsej rreth pesë nisma paralele fetare që operojnë në komuna të ndryshme dhe që funksionojnë jashtë mbikëqyrjes së Bashkësisë Islame të Kosovës.²² Disa prej paraxhemateve ilegale kanë aplikuar për legalizim në Bashkësinë Islame të Kosovës, por janë refuzuar. Refuzimi i kërkesave për legalizim është bërë bazuar në arsyetimin se nuk ka nevojë për vend-falje të reja për të praktikuar Islamin në rajonet ku operojnë paraxhematet ilegale, sepse aktualisht ka numër të mjaftueshëm të xhamive në këto komuna. Integrimi i nismave paralele fetare apo paraxhemateve nën menaxhimin BIK-ut, duke respektuar rregullat e punës së BIK-ut, si dhe legjislacionin e vendit, do të ndihmonte në ruajtjen dhe rregullimin edhe më të mirë të jetës fetare islame në vend.



18 Interviste me njohës të çështjeve të sigurisë. Prishtinë, Qershor 2024

19 Interviste me njohës të çështjeve të sigurisë. Prishtinë, Qershor 2024

20 Ibid:

Kategorizimi dhe shpallja e organizatave terroriste në Kosovë

Kategorizimi i organizatave terroriste në Kosovë bazuar në aktivitetet e tyre në tr vitet e fundit tregon se vendi është përballur me kërcënime dhe rreziqe të ndryshme terroriste gjatë kësaj periudhe. Edhe pse Kosova ende nuk ka përshtatur legjislacionin e saj për procedurat ligjore për shpalljen e organizatave si terroriste, institucionet e shtetit bazohen kryesisht në listat e organizatave terroriste të hartuara nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.²³ Kjo nënkupton që organizatat të cilat shpallen terroriste nga BE dhe SHBA-së, rrjedhimisht trajtohen si organizata terroriste edhe nga Republika e Kosovës.

Në raste të veçanta, kur organizatat të caktuara nuk përfshihen në listat e organizatave terroriste të BE-së dhe SHBA-së, institucionet e Kosovës i vlerësojnë ato si rrezik për sigurinë e saj, atëherë institucionet kosovare i shpallin si terroristë këto organizata përmes vendimeve të veçanta shtetërore, të përgatitura nga ministritë përkatëse të Qeverisë së Kosovës si Ministria e Punëve të Jashtme apo Ministria e Punëve të Brendshme.²⁴ Mungesa e një legjislacioni specifik me kritere të qarta ka ndikuar që Qeveria e Kosovës dhe institucionet e drejtësisë në Kosovë të ndjekin këtë praktikë për të shpallur si terroriste organizatat që paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare dhe qytetarët e saj.²⁵ Një praktikë të tillë, Kosova e ka ndjekur në qershor të vitit 2020, kur Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës shpalli Hezbollah-un si organizatë terroriste, e cila vepron kryesisht në Liban dhe është në konflikt të vazhdueshëm me Izraelin, por që mbështetet dhe financohet nga Republika Islamike e Iranit.²⁶ Gjithashtu, në qershor të vitit 2023, Qeveria e Kosovës ka shpallur organizatat “Mbrojtja Civile” dhe “Brigada e Veriut” si organizata terroriste.²⁷ Sipas Qeverisë së Kosovës, këto dy organizata kanë destabilizuar rendin ligjor dhe kushtetues të Kosovës për vite me radhë dhe kanë paraqitur një kërcënim të serioz për sovranitetin dhe sigurinë e vendit.²⁸

Për aktivitetet e dhunshme të organizatave terroriste, si “Mbrojtja Civile” dhe “Brigada e Veriut”, Policia e Kosovës ka raportuar përplasje të vazhdueshme me individë të përfshirë në këto organizata ekstremiste, të cilët kanë organizuar sulme të armatosura, kanë vendosur barrikada në rrugë dhe kanë penguar shtrirjen e rendit dhe ligjit kryesisht në komunat veriore të Kosovës. Këto grupe ekstremiste, po ashtu, kanë kryer sulme me armë zjarri që kanë rezultuar në vrasje dhe plagosje të qytetarëve civilë, zyrtarëve policorë dhe pjesëtarëve të KFOR-it dhe EULEX-it “Mbrojtja Civile” dhe “Brigada e Veriut” kanë organizuar sulme edhe ndaj civilëve serbë dhe përfaqësuesve politikë të komunitetit serb që janë opozitë e Listës Serbe, e cila vepron nën urdhrat e Beogradit.

Për qëllimet e këtij raporti dhe bazuar në përfshirjen e tyre në aktivitetet e dhunshme të realizuara në Kosovë gjatë 2020-2024, është bërë një vlerësim i nivelit të rrezikut që organizatat terroriste kanë paraqitur për Kosovën. Për analizë janë marrë katër organizata terroriste të cilat më të kaluarën kanë qenë aktive në Kosovë dhe që gjenden në listat e organizatave terroriste të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Dy nga këto organizata, “Mbrojtja Civile” dhe “Brigada e Veriut” janë shpallur si nga Qeveria e Kosovës. Prandaj, për analizë do të shqyrtohen katër organizata terroriste, ku dy prej tyre kanë shtrirje globale, ndërsa dy të tjera në Kosovë dhe Serbi. Ky raport analizon veprimet e këtyre organizatave terroriste në nivel global: i ashtuquajturit Shteti Islamik apo i njohur ndryshe si ISIS ose DAESH dhe organizata tjetër Al Fateh al SHAM, e njohur në të kaluarën si Fronti AL NUSRA. Ndërsa, dy organizatat tjera terroriste që do të analizohen janë Mbrojtja Civile dhe Brigada e Veriut që kanë shtrirje në Kosovë dhe Serbi.

21 Po aty.

22 Për më shumë shih artikullin e Prishtina Insight “Risk of Radicalisation: Kosovo Struggles with Informal Worship Places: Risk of Radicalisation.” <https://prishtinainsight.com/risk-of-radicalisation-kosovo-struggles-with-informal-worship-places-mag/>

23 Intervistë me zyrtar të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Qeverisë së Kosovës. Prishtinë, Qershor 2024

24 Po aty.

25 Po aty

26 Për më shumë shih artikullin e Zërit të Amerikës: “Kosova shpall Hezbollahun organizatë terroriste” - <https://www.zeriamerikes.com/a/5474605.html>

27 Për më shumë shih artikullin e Radios “Evropa e Lirë”. “Kosova shpall “Mbrojtjen Civile” dhe “Brigadën e Veriut” organizata terroriste” <https://www.evropaelire.org/a/mbrojttja-civile-dhe-brigada-e-veriut-shpallen-organizata-terroriste-/32482051.html>

28 Po aty.

Analiza është bërë duke marrë për bazë katër indikatorë kyç

Bazuar në këto kritere që shërbejnë si indikatorë të analizës dhe marrë parasysh aktivitetet e tyre të dhunshme të ndërmarra në Kosovë gjatë vitet 2020-2024, është bërë një kategorizim i nivelit të rrezikut që kanë paraqitur për vendin këto katër organizata terroriste.³⁰

Dëmet që këto organizata terroriste i kanë shkaktuar vendit, përfshirë sulmet dhe tentativat e sulmeve terroriste në Republikën e Kosovës në vitet 2020-2024;

Përfshirjen e qytetarëve të vendit në aktivitetet terroriste si pjesë e këtyre organizatave në vitet 2020-2024;

Ndikimin që këto organizata terroriste kanë pasur në sigurinë dhe rendin juridik të Kosovës në vitet 2020-2024;

Synimet dhe qëllimet destruktive që këto organizata terroriste kanë ndaj rendit dhe sigurisë së Republikës së Kosovës.

FAKTORËT KYÇ

Për qëllime studimore, në vijim prezantohet një përmbledhje dhe vlerësim i disa prej sulmeve më serioze të realizuara nga grupet ekstremiste dhe terroriste në Kosovë.

29 Po aty.

30 Po aty.

31 Të dhëna të mbledhura nga databaza e Institutit për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT, për nevoja të këtij raporti.

32 Po aty.

Kronologji e sulmeve serioze terroriste të realizuara në Kosovë në tri vitet e fundit (2020-2023)

11 PRILL 2022

në fshatin Zubç të Komunës së Zubin Potokut, Policia e Kosovës u sulmua me armë zjarri. Në këtë sulm nuk pati të lënduar apo dëme materiale të raportuara.³³

1

2

15 PRILL 2022

një njësi patrulluese e Policisë së Kosovës në Zubin Potok u sulmua me bombë dore. Sulmet u kryen nga grupet ekstremiste dhe radikale në veri, me qëllim të pengimit të punës zyrtare të Policisë. Nga ky sulm nuk pati dëme materiale apo viktima.³⁴

MË 16 PRILL 2022

dy shpërthime me bomba ndodhën afër patrullave të Policisë së Kosovës, më Leposavic. Sulmet u realizuan nga grupet ekstremiste dhe radikale në veri, me qëllim të pengimit të punës zyrtare të Policisë. Nga ky sulm nuk pati dëme materiale apo viktima.³⁵

3

11 KORRIK 2022

në përpjekje për të ndaluar kontrabandën në veri të vendit, 5 zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës u plagosen në Zvecan, nga individë të grupit ekstremist radikal që operonin në veri të Kosovës.³⁶

4

5

6 DHJETOR 2022

në ndërtesën e KKZ, së në veri të Kosovës, ndodhi një shpërthim me bombë. Ky sulm u krye nga pjesëtarë të grupeve ekstremiste aktive në veri, me qëllim të parandalimit të organizimit të zgjedhjeve të lira në këtë pjesë të vendit. Nga ky sulm u shkaktuan dëme materiale.³⁷

9 DHJETOR 2022

në fshatin Serbovc të Komunës së Zveçanit, grupet ekstremiste sulmuan Policinë e Kosovës, duke plagosur një zyrtar policor. Sulmi kishte si qëllim pengimin e organizimit të zgjedhjeve lokale në atë pjesë të vendit.³⁸

11 DHJETOR 2022

në fshatin Serbovc të Komunës së Zveçanit, grupet ekstremiste sulmuan Policinë e Kosovës, duke plagosur një zyrtar policor. Sulmi kishte si qëllim pengimin e organizimit të zgjedhjeve lokale në atë pjesë të vendit.⁴⁰

8

20 DHJETOR 2022

raportohet se në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicën e Veriut, ndodhi një shpërthim me bombë. Vendosja e bombës u realizua nga individë të grupeve ekstremiste në veri për të penguar organizimin e zgjedhjeve komunale. Nuk pati dëme apo viktima nga ky shpërthim.⁴¹

9

29-30 MAJ 2023

u organizuan protesta të dhunshme në veri të Kosovës. Gjatë këtyre protestave, individë të përfshirë në grupe ekstremiste sulmuan ushtarët e KFOR-it me armë zjarri dhe mjete të tjera. Mbi 90 ushtarë të KFOR-it u lënduan rëndë dhe lehtë gjatë procesit të menaxhimit të protestave. Këto ishin njëra nga protestat më të dhunshme që kanë pësuar ushtarët e KFOR-it gjatë menaxhimit të turmave.⁴²

7

10

10 DHJETOR 2022

në veri të Kosovës, individë të lidhur me grupe ekstremiste si dhe me ato të krimit të organizuar vendosën barrikada në rrugët kryesore kombëtare që çonin në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak. Kjo ndodhi pas arrestimit të Dejan Pantiq, me kombësi serbe, i akuzuar për organizimin e sulmit ndaj KKZ-së në veri të Kosovës. Bllokimet e rrugëve me mjete të rënda transporti e penguan lëvizjen e institucioneve të sigurisë në zonën e caktuar dhe të qytetarëve për rreth 20 ditë.³⁹

39 Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Dhjetor 2022

40 Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Dhjetor 2022

41 Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Dhjetor 2022

42 Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Maj 2023


Sulmi terrorist serb në fshatin Banjskë

Më datën 21 shtator 2023, në fshatin Banjskë të Zveçanit, u organizua një sulm terrorist kundër një njësie patrulluese të Policisë së Kosovës i realizuar nga grupi i organizuar terrorist i mbështetur dhe financuar nga Serbia. Si pasojë e sulmit terrorist, humbi jetën zyrtari policor Afrim Bunjaku, ndërsa një zyrtar tjetër policor u plagos rëndë.⁴³

Pas sulmit terrorist serb i organizuar nga grupi i armatosur rëndë, Policia e Kosovës zbuloi se grupi i organizuar terrorist që kishte kryer sulmin ishte strehuar në Manastirin e Banjskës të Zveçanit.⁴⁴ Bazuar në procedurat e punës, Policia e Kosovës njoftoi KFOR-in dhe EULEX-in për planin e tyre reagues pas këtij sulmi terrorist. Raportohet se i tërë operacioni kundër grupit të armatosur terrorist ka qenë i koordinuar me këto dy misione ndërkombëtare, si reagues të dytë dhe të tretë të sigurisë në vend.⁴⁵

Sipas raporteve zyrtare të Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, në këtë sulm të realizuar nga grupi i armatosur terrorist ishin përfshirë dhjetëra individë që ishin pjesë e organizatave terroriste si Mbrojtja Civile dhe Brigada e Veriut të cilët kishin plane për të kryer sulme të mëdha ndaj institucioneve të Kosovës. Qëllimi i tyre ishte aneksimi i plotë i veriut të Kosovës dhe bllokimi i qasjes së Policisë së Kosovës dhe institucioneve tjetra shtetërore në këtë pjesë të vendit.⁴⁶ Përleshjet midis grupit të armatosur terrorist dhe Policisë së Kosovës filluan në orët e mëngjesit dhe vazhduan për orë të tëra. Kjo rezultoi me 3 anëtarë të grupit të armatosur të vrarë dhe disa të tjerë u arrestuan. Bazuar në të dhënat zyrtare të MPB-së, Kosova

gjatë përballjes me grupin e armatosur terrorist, ka arritur të parandaloj një sulm tjetër të madh terrorist që ishte planifikuar kundër pikave kufitare, bazave të policisë dhe institucioneve shtetërore të rëndësishme në këtë pjesë të shtetit. Të dhënat e mbledhura nga institucionet e sigurisë kanë treguar se grupi kishte për qëllim invadimin e plotë të pjesës veriore të shtetit që mund të kishte pasoja serioze për sigurinë rajonale.⁴⁷ Sulmi i organizuar terrorist në Banjskë dhe mbështetja e grupit të armatosur terrorist nga ana e struktura shtetërore të Serbisë, nën drejtimin e Milan Radojic (gjatë kësaj kohe, ai ishte nënkryetar i Listës Serbe), tregojnë se elementet e ekstremizmit të dhunshëm me bazë etno-nacionaliste ende kanë ndikim në veri të Kosovës dhe paraqesin një rrezik të vazhdueshëm për qytetarët e vendit. Sulmi në Banjskë dhe pasojat që pati ai në procesin e dialogut dhe sigurinë rajonale në përgjithësi janë tregues të mjaftueshëm se Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të zhvillojnë një strategji dhe qasje konkrete për zgjidhjen e konflikteve në rajon. Për më shumë, BE-ja dhe SHBA-ja duhet të jenë më konkret në dënimin dhe sanksionimin e shteteve dhe individëve që mbështesin terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në Ballkanin Perëndimor.



43 Për më shumë shih artikullin e Associated Press "Kosovar police surround a village after Serb gunmen storm a monastery in violence that has killed 4" <https://apnews.com/article/kosovo-serbia-policeman-killed-tension-kurti-vucic-51a29a3159646ec020851b3b5a24836f>

44 Prezantimi i provave në konferencë për media nga Ministri i Punëve të Brendshme i Qeverisë së Kosovës z. Xhelal Svecla dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Gazmend Hoxha. Prishtinë, shtator 2023

45 Po aty

46 Prezantimi i provave në konferencë për media nga Ministri i Punëve të Brendshme i Qeverisë së Kosovës z. Xhelal Svecla dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Gazmend Hoxha. Prishtinë, shtator 2023

47 Po aty

Sekuestrimi i sasisë së madhe të armëve në Veriun e Kosovës

Më 25 shtator 2023, Policia e Kosovës ka bërë sekuestrimin e një sasi të madhe të armatimit dhe municionit të fshehur në manastirin e fshatit Banjskë dhe në lokacione të tjera në veri të Kosovës. Ky arsenal luftarak përfshinte një gamë të gjerë armësh të kalibrit të lehtë dhe të rëndë, si dhe automjete të blinduara, të cilat i takonin grupit të armatosur terrorist që kishin kryer sulmin terrorist⁴⁴ në Banjskë.⁴⁸ Në listën e armatimeve të sekuestruara përfshiheshin automjete të blinduara, kallashnikov, mitraloz, mina, eksploziv me telekomandë, bomba dore, snajper, municione luftarake, top dore, maska, uniforma ushtarake dhe policore serbe, jelek anti-plumb, pajisje komunikimi, harta, dronë, raketa anti-tank dhe një sërë armatimesh të tjera, të mjaftueshme për të pajisur një batalion të plotë këmbësorie me armatim të rëndë.⁴⁹ Kjo sasi e madhe e armatimit të sekuestruar tregon për shkallën e sulmeve që “Mbrojtja Civile dhe Brigada e Veriut” kishin përgatitur kundër institucioneve vendore me qëllim të aneksimit të plotë të veriut të Kosovës. Në shkurt të vitit 2023, Policia e Kosovës arrestoi një person me emrin V.B, i dyshuar për organizimin e sulmeve terroriste kundër komunitetit LGBTQI në Kosovë. Ai u arrestua dhe si prova u gjetën harta të ndryshme dhe materiale tjera që dëshmonin planifikimin e sulmeve terroriste në vend. Personi i akuzuar është nën hetim nga organet e drejtësisë dhe është dënuar me 3.5 vjet burg. I arrestuari për këtë tentim sulm ishte inspiruar nga ideologjia e ISIS-it. Në këtë rast, nuk raportohet asnjë dëm material apo lëndim fizik.⁵⁰ Policia e Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë në vitin 2021 arritën të parandalonin një tentativë sulmi terrorist. Në këtë rast, u arrestuan personat me inicialet M.B., Gj.A., S.E. dhe S.N. si të dyshuar për veprat terroriste që planifikonin të kryenin. Po ashtu, u sekuestruan armë të ndryshme dhe bomba dore, që dyshohet se do të përdreshin për realizimin e sulmeve të mundshme terroriste. Nga ky tentim sulmi terrorist nuk u shkaktuan dëme materiale apo lëndime fizike.⁵¹

Kategorizimi i organizatave terroriste në Kosovë Rezultatet e të dhënave empirike, qofshin ato zyrtare apo të mediave, tregojnë se grupet ekstremiste etno-nacionaliste kanë qenë kryesisht të përfshirë në sulme të dhunshme terroriste në Kosovë, të realizuara në tre vitet e fundit, krahasuar me subjektet terroriste të motivuara mbi baza fetare. Këto sulme kanë shkaktuar shkatërrime të pronës publike dhe private, vdekje dhe plagosje të qytetarëve, duke përhapur frikë, terror dhe duke përdorur dhunën për arritjen e qëllimeve politike. Në tre vitet e fundit, AKI-ja dhe PK-ja kanë parandaluar gjithashtu dy tentativa të sulmeve terroriste në Kosovë. Individët e përfshirë ishin të motivuar nga ideologjia e organizatave si ISIS dhe individët e përfshirë në këto⁵² tentim sulme janë arrestuar dhe kanë marrë dënime të formës së prerë nga gjykatat në Kosovë.

Siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme, në vitet e fundit, harta e subjekteve që kanë shkaktuar kërcënime dhe rreziqe të terrorizmit për Kosovën ka ndryshuar. Deri në vitin 2019, ISIS ishte organizata kryesore ekstremiste e dhunshme që paraqiste kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës. Megjithatë, ky trend ka ndryshuar në tre vitet e fundit, dhe tani burimi kryesor i terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm për vendin vjen nga elementet etno-nacionaliste dhe politike të terrorizmit, të përhapura nga organizatat si Mbrojtja Civile dhe Brigada e Veriut. Ky ndryshim i subjekteve të kërcënimeve nga terrorizmi në Kosovë kërkon një përqendrim më të madh nga Qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare për hartimin e një strategjie për parandalimin e terrorizmit, bazuar në elementet etno- nacionaliste.

48 Prezantimi i provave në konferencë për media nga Ministri i Punëve të Brendshme i Qeverisë së Kosovës z. Xhelal Svecla dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Gazmend Hoxha. Prishtinë, shtator 2023

49 Prezantimi i provave në konferencë për media nga Ministri i Punëve të Brendshme i Qeverisë së Kosovës z. Xhelal Svecla dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Gazmend Hoxha. Prishtinë, shtator 2023

50 Të dhëna nga databaza e përgaditur nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT për nevoja të këtij hulumtimi. Qershor 2024

51 Po aty

52 Të dhëna nga databaza e përgaditur nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT për nevoja të këtij hulumtimi. Qershor 2024

Sekuestrimi i sasisë së madhe të armëve në Veriun e Kosovës

Më 25 shtator 2023, Policia e Kosovës ka bërë sekuestrimin e një sasi të madhe të armatimit dhe municionit të fshehur në manastirin e fshatit Banjskë dhe në lokacione të tjera në veri të Kosovës. Ky arsenal luftarak përfshinte një gamë të gjerë armësh të kalibrit të lehtë dhe të rëndë, si dhe automjete të blinduara, të cilat i takonin grupit të armatosur terrorist që kishin kryer sulmin terrorist⁴⁴ në Banjskë.⁴⁸ Në listën e armatimeve të sekuestruara përfshiheshin automjete të blinduara, kallashnikov, mitraloz, mina, eksploziv me telekomandë, bomba dore, snajper, municione luftarake, top dore, maska, uniforma ushtarake dhe policore serbe, jelek anti-plumb, pajisje komunikimi, harta, dronë, raketa anti-tank dhe një sërë armatimesh të tjera, të mjaftueshme për të pajisur një batalion të plotë këmbësorie me armatim të rëndë.⁴⁹ Kjo sasi e madhe e armatimit të sekuestruar tregon për shkallën e sulmeve që “Mbrojtja Civile dhe Brigada e Veriut” kishin përgatitur kundër institucioneve vendore me qëllim të aneksimit të plotë të veriut të Kosovës. Në shkurt të vitit 2023, Policia e Kosovës arrestoi një person me emrin V.B, i dyshuar për organizimin e sulmeve terroriste kundër komunitetit LGBTQI në Kosovë. Ai u arrestua dhe si prova u gjetën harta të ndryshme dhe materiale tjera që dëshmonin planifikimin e sulmeve terroriste në vend. Personi i akuzuar është nën hetim nga organet e drejtësisë dhe është dënuar me 3.5 vjet burg. I arrestuari për këtë tentim sulm ishte inspiruar nga ideologjia e ISIS-it. Në këtë rast, nuk raportohet asnjë dëm material apo lëndim fizik.⁵⁰ Policia e Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë në vitin 2021 arritën të parandalonin një tentativë sulmi terrorist. Në këtë rast, u arrestuan personat me inicialet M.B., Gj.A., S.E. dhe S.N. si të dyshuar për veprat terroriste që planifikonin të kryenin. Po ashtu, u sekuestruan armë të ndryshme dhe bomba dore, që dyshohet se do të përdreshin për realizimin e sulmeve të mundshme terroriste. Nga ky tentim sulmi terrorist nuk u shkaktuan dëme materiale apo lëndime fizike.⁵¹

Kategorizimi i organizatave terroriste në Kosovë Rezultatet e të dhënave empirike, qofshin ato zyrtare apo të mediave, tregojnë se grupet ekstremiste etno-nacionaliste kanë qenë kryesisht të përfshirë në sulme të dhunshme terroriste në Kosovë, të realizuara në tre vitet e fundit, krahasuar me subjektet terroriste të motivuara mbi baza fetare. Këto sulme kanë shkaktuar shkatërrime të pronës publike dhe private, vdekje dhe plagosje të qytetarëve, duke përhapur frikë, terror dhe duke përdorur dhunën për arritjen e qëllimeve politike. Në tre vitet e fundit, AKI-ja dhe PK-ja kanë parandaluar gjithashtu dy tentativa të sulmeve terroriste në Kosovë. Individët e përfshirë ishin të motivuar nga ideologjia e organizatave si ISIS dhe individët e përfshirë në këto⁵² tentim sulme janë arrestuar dhe kanë marrë dënime të formës së prerë nga gjykatat në Kosovë.

Siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme, në vitet e fundit, harta e subjekteve që kanë shkaktuar kërcënime dhe rreziqe të terrorizmit për Kosovën ka ndryshuar. Deri në vitin 2019, ISIS ishte organizata kryesore ekstremiste e dhunshme që paraqiste kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës. Megjithatë, ky trend ka ndryshuar në tre vitet e fundit, dhe tani burimi kryesor i terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm për vendin vjen nga elementet etno-nacionaliste dhe politike të terrorizmit, të përhapura nga organizatat si Mbrojtja Civile dhe Brigada e Veriut. Ky ndryshim i subjekteve të kërcënimeve nga terrorizmi në Kosovë kërkon një përqendrim më të madh nga Qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare për hartimin e një strategjie për parandalimin e terrorizmit, bazuar në elementet etno- nacionaliste.

48 Prezantimi i provave në konferencë për media nga Ministri i Punëve të Brendshme i Qeverisë së Kosovës z. Xhelal Svecla dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Gazmend Hoxha. Prishtinë, shtator 2023

49 Prezantimi i provave në konferencë për media nga Ministri i Punëve të Brendshme i Qeverisë së Kosovës z. Xhelal Svecla dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Gazmend Hoxha. Prishtinë, shtator 2023

50 Të dhëna nga databaza e përgaditur nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT për nevoja të këtij hulumtimi. Qershor 2024

51 Po aty

52 Të dhëna nga databaza e përgaditur nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT për nevoja të këtij hulumtimi. Qershor 2024

Organizata	Ideologjia	Rreziku	Shënjestrat	Burimet e mbështetjes	Sulme gjatë viteve 2020-2024	Dëmi i shkaktuar gjatë viteve 2020-2024	Vendi i operimit
ISIS	Ekstremizëm islamik - ekstremizëm xhihadist	I lartë	Popullata civile, institucionet shtetërore, Perëndimi	Nuk ka mbështetje në Kosovë	2 tentim sulme terroriste të parandaluara	0	Shtirje globale
AL FATEH al Sham	Ekstremizëm islamik - ekstremizëm xhihadist	I ulët	Regjimi sirian i Bashar al Asad, ISIS	Nuk ka mbështetje në Kosovë	Asnjë	Asnjë	Siri, Irak
Mbrojtja Civile	Etno-nacionalizëm politik	Shumë i lartë	Institucionet shtetërore Popullata civile serbe dhe shqiptare kundërshtarët politik, KFOR EULEX	Mbështetje politike nga Serbia, Krimi i organizuarL ista Serbe	Mbi 10 sulme terroriste të raportuara	3 viktima, mbi 150 të plagosur, dëme ⁴⁷ materiale	Kosovë, Serbi
Brigada e Veriut	Etno-nacionalizëm politik	Shumë i lartë	Popullata civile serbe kundërshtarët politik, KFOR EULEX	Institucione t e Serbisë, Krimi i organizuarL ista Serbe	Mbi 10 sulme terroriste të raportuara	3 viktima, mbi 150 të plagosur, dëme materiale	Kosovë, Serbi

Përfundimet

Ndryshimet gjeopolitike të shkaktuara nga pushtimi i Ukrainës nga Rusia, si dhe konflikti në mes Hamasit dhe Izraelit në njërin anë si dhe Izraelit dhe Iranit në anën tjetër, kanë krijuar një botë të paqëndrueshme nga aspekti i sigurisë. Pasojat e këtyre ngjarjeve po sjellin pasoja edhe në Kosovë dhe gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Si rezultat i fokusit më të madh të Perëndimit në mbështetje të Ukrainës në luftën e saj kundër Rusisë, këndvështrimi i tyre ndaj ngjarjeve në Ballkanin Perëndimor dhe Kosovë po ndryshon dhe po zbehet. Kjo përfshin kufizimin e burimeve financiare dhe njerëzore për të trajtuar problemet e sigurisë me të cilat ballafaqohet Kosova dhe rajoni, veçanërisht sfidat të cilat lidhen me parandalimin dhe luftimin e formave të ndryshme të terrorizmit, qoftë islamik, të djathtës ekstreme apo atij etno-nacionalist.

Ky boshllëk gradualisht po mbulohet nga akterë të jashtëm, si Rusia dhe Irani, të cilët kanë plane afatgjata për të përhapur konflikte nëpër botë dhe për të zvogëluar rolin, ndikimin dhe prezencën e Perëndimit në skenën globale.

Si rezultat i ndryshimit të fokusit perëndimor ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor, grupet radikale dhe ekstremiste, të mbështetura nga elemente shtetërore nga Serbia dhe Rusia, kanë përfituar terren, duke u trajnuar dhe pajisur për të organizuar sulme kundër prezencës ndërkombëtare në veri të vendit, si dhe kundër institucioneve shtetërore të Kosovës.

Institucionet shtetërore të sigurisë në Kosovë kanë përballuar me sukses ekstremizmin dhe terrorizmin e dhunshëm, duke parandaluar sulmet terroriste dhe duke i përballuar ato me maturitet, profesionalizëm dhe duke minimizuar dëmet, qoftë nga grupet sulmuese apo nga personeli i tyre.

REKOMANDIMET

Për të adresuar kërcënimet e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, Qeveria e Kosovës, partnerët ndërkombëtar dhe shoqëria civile duhet të ndërmarrin një sërë veprimesh:

1. Qeveria e Kosovës duhet të përshtatë politikat dhe strategjitë e saj të sigurisë për të adresuar kërcënime dhe rreziqe nga terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Në kuadër të dokumenteve aktuale të sigurisë, duhet të shtohen veprimet hetuese e parandaluese për të adresuar kërcënime dhe rreziqe që burojnë nga elementet terroriste, të cilat i përkasin ideologjive etno- nacionaliste dhe të së djathtës ekstreme.

2. Qeveria e Kosovës duhet të zhvillojë një qasje më gjithëpërfshirëse për luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ndaj subjekteve që operojnë në veri të Kosovës. Përveç arrestimeve dhe ndëshkimeve të zbatuara nga Policia e Kosovës dhe organet e drejtësisë, Qeveria duhet të hartojë strategji të qëndrueshme për të forcuar besimin mes institucioneve shtetërore dhe komunitetit serb që jeton në komunat veriore të Kosovës. Këto veprime të qëndrueshme ndihmojnë Qeverinë të forcojë lidhjet me komunitetin dhe të parandalojë presionin nga organizatat si “Mbrotjtja Civile” apo “Brigada e Veriut” që ushtrojnë ndaj komunitetit serb në veri të vendit.

3. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta marrë parasysh dhe trajtoj me prioritet rrezikun nga grupet radikale etno-nacionaliste që veprojnë në veri të vendit, të mbështetura nga Serbia dhe Rusia. BE-ja dhe SHBA-ja duhet të mbështesë Qeverinë e Kosovës në përballje me këto grupe me të njëjten nivel, siç e ka mbështetur Kosovën gjatë viteve paraprake në përballje me ekstremizmin islamik të përfaqësuar nga ISIS. Një përgjigje e dobët ndaj terrorizmit nga elementet etno-nacionaliste në Veri mund të shtojë dëshirën dhe planet e organizatave si “Mbrotjtja Civile” apo “Brigada e Veriut” për të organizuar sulme të mëdha në funksion të destabilizimit të rajonit, duke u mbështetur në një plan afatgjatë nga Serbia dhe Rusia.

4. Bashkësia ndërkombëtare duhet të mbaj një prezencë dhe fokus më të qëndrueshëm në çështjet e Ballkanit Perëndimor, një rajon i cili është shumë i lëkundshëm dhe me potencial për të gjeneruar konflikte të reja. Mungesa e fokusit të Perëndimit në Ballkanin Perëndimor krijon hapësirë për rritjen e ndikimit të organizatave dhe vendeve armiqësore, si Rusia dhe Irani, që synojnë të krijojnë konflikte të reja duke mbështetur individë ose organizata nën kontrollin e tyre.

5. Bashkësia Islame e Kosovës duhet të gjejë mënyra për të parandaluar përhapjen e nismave ilegale fetare apo paraxhemateve në Kosovë. Duke përdorur autoritetin dhe mandatin e saj, BIK-u në bashkëpunim me institucionet shtetërore, duhet të angazhohet për të ndaluar fuqizimin e nismave fetare apo paraxhemateve që operojnë jashtë juridiksionit të saj. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet praktikave dhe mundësive që paraxhematet apo nismat ilegale fetare islame në Kosovë të vendosën nën kontrollin e BIK, duke respektuar praktikën dhe rregullat e punës së BIK-ut.

6. Qeveria e Kosovës duhet të organizojë takime të rregullta me komunitetin serb që jeton në veri të vendit, gjegjësisht në komunat veriore. Kjo qasje ndihmon Qeverinë të kuptojë më mirë shqetësimet e sigurisë të komunitetit serb dhe ndihmon këtë të fundit të integrohet më lehtë në jetën institucionale dhe shoqërore të vendit.

7. Qeveria e Kosovës duhet të miratojë legjislacion që i parashikon hapat konkret për shpalljen e subjekteve ose organizatave të ndryshme si terroriste. Ky legjislacion duhet të parasheh standardet dhe praktikën më të mira të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare aleate të Kosovës, si SHBA-ja dhe BE-ja, të cilat kanë rregulluar procedurat dhe hapat institucionalë për shpalljen e subjekteve apo organizatave të ndryshme që paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare si terroriste.

